

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT


Shkurt 2026

Norma e inflacionit e matur me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin Shkurt 2026 ishte 2,5 për qind, nga 1,9 për qind në Shkurt 2025.

Krahasuar me muajin Janar 2026, çmimet e konsumit u rritën me 0,5 për qind.


Rritja vjetore e çmimeve në Shkurt 2026 u ndikua kryesisht nga grupi "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" me 5,3 %, pasuar nga "Sigurime dhe shërbime financiare" me 4,3 %, "Argëtim, sport dhe kulturë" me 4,2 %, "Restorante dhe shërbime akomodimi" me 2,4 %, "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me 2,3 %, "Pije alkoolike dhe duhan" dhe "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 2,2 % secili, "Shërbimi arsimor" me 1,9 %, "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 1,7 %, etj.

FIG. 1 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT (%)



Krahasuar me Janar 2026, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 0,9 %, pasuar nga grupet "Argëtim, sport dhe kulturë" me 0,7 %, "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" me 0,6 %, "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 0,3 %, "Shëndeti" me 0,2 %, etj. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Veshje dhe këpucë" u ulën me 0,3 %, pasuar nga grupet "Informacioni dhe komunikimi" dhe "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me 0,1 % secili.

FIG. 2 NDIKIMI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Shkurt është ndikuar kryesisht nga grupi "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" me +1,06 pikë përqindje, pasuar nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +0,60 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me + 0,15 pikë përqindje, çmimet e grupit "Restorante dhe shërbime akomodimi" ndikuan me +0,13 pikë përqindje, çmimet e grupit "Pije alkoolike dhe duhan" me +0,11 pikë përqindje, çmimet e grupit "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me +0,10 pikë përqindje, çmimet e grupit "Argëtim, sport dhe kulturë" me +0,08 pikë përqindje, çmimet e grupeve "Shërbimi arsimor" dhe "Sigurime dhe shërbime financiare" me +0,06 pikë përqindje secili, çmimet e grupeve "Transporti" dhe "Informacioni dhe komunikimi" me +0,03 pikë përqindje secili, çmimet e grupeve "Veshje dhe këpucë" dhe "Shëndeti" me +0,02 pikë përqindje secili.

TAB. 1 INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Kodi	Grupet	Peshat	02-26/Viti 2025	02-26/01-26	02-26/02-25
	Gjithsej	100	101,9	0,5	2,5
01.	Ushqime dhe pije joalkolike	34,1	102,3	0,9	1,7
02.	Pije alkolike dhe duhan	5,0	101,7	0,1	2,2
03.	Veshje dhe këpucë	3,8	100,2	-0,3	0,5
04.	Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera	20,2	103,0	0,6	5,3
05.	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,0	101,6	0,3	2,2
06.	Shëndeti	3,2	100,4	0,2	0,5
07.	Transporti	6,4	100,1	0,0	0,4
08.	Informacioni dhe komunikimi	3,6	100,4	-0,1	0,8
09.	Argëtim, sport dhe kulturë	2,0	101,9	0,7	4,2
10.	Shërbimi arsimor	3,0	101,3	0,0	1,9
11.	Restorante dhe shërbime akomodimi	5,7	101,4	0,1	2,4
12.	Sigurime dhe shërbime financiare	1,5	104,4	0,0	4,3
13	Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme	4,5	101,7	-0,1	2,3

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Indeksi i Çmimeve të Konsumit](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Indeksi i Çmimeve të Konsumit](#)

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Duke filluar nga Shkurt 2026, Indeksi i Çmimeve të Konsumit përlogaritet sipas klasifikimit ECOICOP 2018. Kalimi në klasifikimin e ri përfshin ristrukturimin e artikujve të shportës, riklasifikimin e disa produkteve. Struktura e ECOICOP ver. 2 përbëhet nga 13 divizione kryesore, të detajuara më tej në grupe, klasa dhe nënklasa. Implementimi i këtij klasifikimi është në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/3159, duke siguruar harmonizimin e plotë me praktikën statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.

Periudha e referencës së indeksit është ndryshuar nga Dhjetor 2020 = 100 në 2025 = 100.

Gjithashtu, në muajin Janar si çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2024.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga **411** produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.